



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 2/1 Prot.

Tiranë, më 17.10.2025

Lënda: Përcillet Vendimi i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë

FAKULTETIT TË MJEKËSISË
FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE
FAKULTETIT TË MJEKËSISË DENTARE

K Ë T U

Për dijeni:

PROF. DR. XHELADIN DRAÇINI
REKTOR I UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Z. ARLIND BROCI
ADMINISTRATOR I UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

K Ë T U

Bashkëlidhur ju përcjellim Vendimin nr. 1, datë 17.10.2025, të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë *“Për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet e anëtarëve të komisioneve të Përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”*.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KRYETARI

Myzafer Kaçaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 2 Prot.

Tiranë, më 17.10.2025

VENDIM

Nr. 1, datë 17.10.2025

**PËR FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET E ANËTARËVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR” NË NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË,
TIRANË**


Në zbatim të neneve 4, 5, 6 e vijues të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë; të Urdhrit të Rektorit të UMT-së nr. 93, datë 13.10.2025, “Për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët për anëtar të Komisionit të Përhershëm për dhënie të gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”; të Urdhrit të Rektorit të UMT-së nr. 94, datë 13.10.2025, “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Komisionin e Përhershëm për dhënie të gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 17.10.2025,


VENDOSI:

1. Të shpallë fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet e anëtarëve të komisioneve të përhershme për dhënie të gradës shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë në:
 - 1) Fakultetin e Mjekësisë, UMT.
 - 2) Fakultetin e Mjekësisë Dentare, UMT.
 - 3) Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, UMT.
2. Të miratojë periudhën e zhvillimit të procesit zgjedhor nga data **19.10.2025** deri më datë **19.11.2025** dhe datën **19.11.2025**, si datë të votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të Përhershme sipas pikës 1 të këtij Urdhri.


3. Komisionet e Zgjedhjeve të Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë Dentare dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, UMT, të nisin procedurën e pranimi të aplikimeve të kandidatëve për anëtarë të komisioneve të përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor” nga data **27.10.2025** deri në datë **31.10.2025** dhe të shpallin listën përfundimtare të aplikantëve sipas përcaktimeve të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.
4. Formularët e aplikimit të dorëzohen pranë KZF-së përkatëse, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij Vendimi, si dhe në zbatim të Urdhrit të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr. 93, datë 13.10.2025, “Për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët për anëtar të komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, drejtuesit e njësive kryesore dhe Komisionet e Zgjedhjeve të Fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT, afishohet në mjediset e njësive kryesore dhe publikohet në faqet e tyre zyrtare.




Adela Perolla

Fatmir Lela


Edlira Rruci

Gentjan Asllanaj


Daniela Tasha

Arnold Rrushi